



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1450/2 Prot.

Tiranë, më 17.05.2017

- Lënda :** Informacion për procesin e verifikimit dhe plotësimit të dokumentacionit të kandidatëve nga avokatia për KLGJ
- Drejtuar:** Znj.Genoveva Ruiz Calavera  
Kryetare e Bordit Drejtues të Operacionit Ndërkombëtar i Monitorimit
- Në Vëmendje të:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit  
Delegacionit të Bashkimit Europian

**TIRANË**

*E nderuar Znj. Calavera,*

Sikurse jeni vënë në dijeni me shkresën Nr.1450/1, dt.15 Maj 2017, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është duke kryer procedurat e verifikimit për plotësimin e kriterëve ligjore të listës së kandidatëve për KLGJ nga avokatia, të përcjellë në Kuvendin e Shqipërisë më datë 15 Maj 2017 nga Komisioni i Pavarur Ad-Hoc i ngritur pranë Avokatit të Popullit.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara për Sekretarin e Përgjithshëm sipas pikave 2, 3, 4, të nenit 35 të ligjit të lartcitur, ky i fundit me qëllim plotësimin e dokumentacionit në përputhje me kushtet që parashikon neni 19 i ligjit, gjatë verifikimit, ka konstatuar se disa kandidatëve u mungojnë kryesisht dokumentacion ligjor si më poshtë:

- Vërtetim nga tatimet që kandidati nuk është debitor sipas kërkesës së gërmës “ç” të pikës 3 të nenit 19 të ligjit 115/2016;
- Vërtetim të gjëndjes gjyqësore se kandidati është i padënuar, sipas kërkesës së gërmës “ë” të pikës 3 të nenit 19 të ligjit 115/2016;
- Kartë të licencës së ushtrimit të profesionit të avokatisë të vlefshme për të treja shkallët e gjykimit, e rinovuar, sipas kërkesës së gërmës “dh” të pikës 3 të nenit 19 të ligjit 115/2016

Për sa më sipër, këtyre kandidatëve u janë komunikuar sot datë 17 Maj 2017, përmes postës elektronike të deklaruar, mangësitë që kanë në dosje duke kërkuar një afat 5 ditor bazuar në parashikimet e pikës 3 të nenit 35 të ligjit ( data 22 Maj 2017 ) afat brenda të cilit këta kandidatë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e plotësuar.



Në përfundim të këtij afati, në ushtrim të funksioneve të tij kushtetuese dhe ligjore, Sekretari i Përgjithshëm do t'ju infomojë për ecurinë e procesit dhe do t'ju vërë në dispozicion dokumentacionin plotësues që do të paraqitet nga kandidatët.

Duke ju shprehur konsideratat e mia më të larta ,

Albana SHTYLLA

SEKRETARE E PËRGJITHSHME

